



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM

Nr 114 Datë 24. 12. 2007

MIRATIM FONDI PËR ZHVILLIMIN E AKTIVITETEVE PËR FESTAT E
FUNDVITIT

Këshilli i Bashkisë i Qytetit Korçë, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë relacionin e paraqitur nga Sektori i Kulturës dhe Drejtoria e Financës për "Miratim Fondi për Zhvillimin e Aktiviteteve për Festat e Fundvitit", bazuar në ligjin nr 8652 datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", neni 32, pika 'dh' dhe pika 'm', ligjin nr 8399 datë 09.09.1998 "Për Buxhetin Lokal" ligji nr 9645 datë 27.11.2007 të M.F. "Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2007", Udhëzimin nr.353 dt. 19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për Zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për Vitin 2007" si dhe VKB nr 2 datë 02.02.2007 "Mbi miratim e Buxhetit të Bashkisë" dhe institucioneve të varësisë për vitin 2007, mbështetur në kompetencat që ka dhe pas diskutimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

1. Të miratojë fondin prej 713 000 lekë, për realizimin e aktiviteteve artistike e sociale për festat e fundvitit të detajuara sipas preventivave përkatës.

- a) Ndihmë për familjet në vështirësi ekonomike (pako ushqime).

390 familje x 1000 lek/pako = 390 000 lek

- b) Shpërblim për fëmijë e policëve të rënë në krye të detyrës (shpërblim në lek).

6 familje x 5 000 lek = 30 000 lek

- c) Dhurata për fëmijët pjesëmarrës në Ekspozitën "Cicërima mbi Telajo".

100 fëmijë x 500 lek = 50 000 lek

d) Koncert i "Javës së Festave" tek Katedralja.

PROJEKT BUXHET FESTAT E FUNDVITIT
Koncert me Muzike nga Festat, Katedralja

Nr	Zeri	Sasia	Njesia	Cmimi/lek	Totali/lek
1	Koncert duo per flaut	2		15 000	30 000
1	Kengetar	2		10 000	20 000
2	Kengetar i ftuar nga Tirana	1		25 000	25 000
3	Kengetare	6		5 000	30 000
4	Kengetare femije	4		2 000	8 000
5	Teater Kukullash	10		2000	20 000
6	Dj/Foni	1		25 000	25 000
7	Plaku i Vitit te Ri	1		15 000	15 000
8	Aktor	1		10 000	10 000
9	Prezantues	1		10 000	10 000
10	Prodhim/Transmetim Spoti	1		15 000	15 000
11	Transmetim Spoti	20	dite	1000	20 000
12	Transmetim spot TVK	10	dite	1500	15 000
TOTAL					243 000

2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet	00	04980	05	Art. 609.1100	-713 000
Shtohet	00	01110	05	Art. 602.0000	+490.000 (Bashkia)
Shtohet	00	01110	05	Art. 606.0000	+30. 000 (Bashkia)
Shtohet	00	08250	05	Art. 602.0000	+193.000 (Teatri)

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Kulturës, Drejtoria e Financës në Bashki dhe Institucioni i Teatrit.

KRYETAR

Raimonda NASE

Raimonda Nase